



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.04.2025
Numër Protokolli: 2756/2025

A.nr.438/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.438/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesi I.K, kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “*vërejtje me shkrim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.438/2025, e datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesi I.K.

II. Shfuqizohet “*Vërejtja me shkrim*” me numër protokolli DKA Nr.120/25, e datës 17.01.2025, e Shefit të Sektorit të Arsimit, përmes të cilës ankuesit sipas pikës I të dispozitivit i është shqiptuar masa disiplinore “*vërejtje verbale*”.

III. Obligohet Menaxheri i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke larguar masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, I.K (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi), më datë 05.03.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 10.03.2025, dhe protokolluar me numër 1533/2025, kundër *Vërejtjes me shkrim* me numër protokolli DKA Nr.120/25, të datës 17.01.2025, të Shefit të Sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prizrenit, përmes të cilës ankuesit sipas pikës I të dispozitivit i është shqiptuar masa disiplinore “*vërejtje verbale*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit më datë 04.04.2024, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit), administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1533/2025 të datës 10.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 10.12.2019; Ankesën e parashtruar tek Komisioni i Ankesave i Komunës së Prizrenit; Aktvendimin me Nr.01-030/01-16318 të datës 04.02.2025; Vërejtjen me shkrim me numër protokolli DKA Nr.120/25 të datës 17.01.2025; E-mailin e datës 05.08.2024, 16.07.2024, 17.12.2024, 16.12.2024; 17.12.2024; 19.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2025; Akt emërimit AE.Nr.01-112-169210/01 të datës 11.12.2020 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimit të datës 29.10.2015 dhe përshkrimin e detyrave të punës, të Shefit të Sektorit për Arsim; E-mailin e datës 18.12.2024, së bashku me korrespondimet; Formularët vlerësimit të rezultateve të punës të ankuesit të datës me numër protokolli DKA Nr.33/25 të datës 21.02.2025; DKA Nr.229/24 të datës 29.01.2024; 23.01.2023; Formularin për vlerësimin e punës provuese me numër protokolli DKA 4505/20 të datës 18.11.2020; Vendimin me Nr.01-116-70456 të datës 31.05.2024; Raportin e ankuesi të datës 19.12.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstatoi se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesi sipas Akt emërimit AE.Nr.01-112-169210/01 të datës 11.12.2020, është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Vlerësim në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prizrenit.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se Shefi i Sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prizrenit, përmes “*Vërejtjes me shkrim*” me numër protokolli DKA Nr.120/25 të datës 17.01.2025, ankuesit sipas pikës I të dispozitivit i ka shqiptuar masën disiplinore “*vërejtje verbale*”, për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës në afat të caktuar, përdorim të gjuhës

fyese dhe nënçmuese, duke shkelur kodin e etikës dhe mos respektimin e hierarkisë në punës, ndërsa ushtrimin e mjeteve juridike kundër këtij vendimi apo këshillën juridike, shqiptuesi gabimisht e ka përcaktuar tek Komisioni i Ankesave në Komunën e Prizrenit.

Rrjedhimisht, sipas Aktvendimit me Nr.01-030/01-16318 të datës 04.02.2025, rezulton se ankuesi kishte parashtruar ankesë tek Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik, i cili përmes këtij Aktvendimi ishte shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, dhe duke qenë se kishte konstatuar se pozita e tij hynë në kategorinë e nëpunësve civil sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, të njëjtin duke vepruar sipas nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, e ka udhëzuar të drejtohet me ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Si rrjedhojë, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu që propozon aprovimin e ankesës si të bazuar dhe anulimin e aktit administrativ/vendimit të ankimuar.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik lidhur me përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht: Neni 55, i cili përcakton se: *1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim.*; Neni 56 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet se: *1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.*; Neni 57 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësve/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim.*

Duke u bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore, Kolegji i Këshillit ka analizuar “Vërejtjen me shkrim” me numër protokolli DKA Nr.120/25, të datës 17.01.2025, dhe si rrjedhojë konstaton se shqiptuesi i masës disiplinore duke u bazuar në nenin 57 paragrafin 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nuk ka përcaktuar saktësisht se cilën prej këtyre tri masave të lehta disiplinore të lartë theksuara i ka shqiptuar ankuesit, ngase faktikisht titulli i kësaj masë është “Vërejtje me shkrim”, mirëpo sipas pikës I të dispozitivit ankuesit i është shqiptuar “Vërejtje verbale”, e që në rastin konkret duke mos e kualifikuar specifikisht masën disiplinore apo duke i shqiptuar dy masa tilla njëkohësisht është krijuar konfuzitet dhe paqartësi, veprime këto në kundërshtim edhe me nenin 61 paragrafin 5 të këtij ligji ku përcaktohet se: *5. Për çdo shkelje shqiptohet vetëm një masë disiplinore.*, ndër të tjera edhe shkeljet supozuara ndaj ankuesit si në arsyetimin e këtij vendimi,

për mos përmbushje të detyrave të punës sipas afatit të caktuar si dhe shkelje e kodit të etikës për shkak të gjuhës fyese dhe nënçmuese, sipas Nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, cilësohen si shkelje të rënda të detyrave dhe përgjegjësisë të punës, dhe se bazuar në Nenin 58 paragrafin 2 të këtij ligji, kompetent për shqiptimin e këtyre masave disiplinore ndaj shkeljeve të rënda është komisioni disiplinor, rrjedhimisht Kolegji thekson se fillimisht duhet cilësuar shkeljet e pretenduara disiplinore dhe më tej në kuptim të kompetencës të veprohet sipas procedurave ligjore, mirëpo faktikisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejt nuk ka arritur ti kualifikoj shkeljet e pretenduara të ankuesit.

Tutje, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës po ashtu ka gjetur se ankuesi sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës me numër protokolli DKA Nr.331/25 të datës 21.02.2025, nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë apo Shefi i Sektorit të Arsimit është vlerësuar se ka arritur përmbushjen e objektivave për vitin 2024, ndërsa tek komentet e mbikëqyrësit për ankuesin, ndër të tjera i njëjti ka theksuar se, citoj: *ka treguar aftësi të veçanta në planifikim, organizim dhe koordinim të aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimit dhe trajnimeve të tyre; ka kryer me sukses efikas dhe efektivitet të gjitha përgjegjësitë e planifikuara dhe ka zgjedhur problemet si dhe sjell kreativitet dhe ka dhënë ide të reja; ka krijuar ambient motivues pune gjatë procesit të vlerësimit të performancës së drejtorëve të shkollave dhe ka bashkëpunuar me koordinatorët e cilësisë në vlerësimin e brendshëm të shkollave si dhe ka shfaqur shkathtësi duke realizuar detyrat e punës në mënyrë profesionale; ka shfaqur aftësi të larta për të krijuar ambient motivues dhe ka marrë vendime të drejta dhe komfor përgjegjësisë; ka treguar aftësi për t'i menaxhuar në mënyrë të shkëlqyer detyrat e punës përmes një komunikimi korrekt me drejtuesit, kolegët dhe palët; si dhe ka theksuar se ankuesi është bashkëpunues dhe merrë pjesë në grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë.*, ndaj si rrjedhojë arsyetimi i aktit të ankimit apo shkeljet e pretenduara nga ankuesi, rezultojnë se janë në kundërtënie me vlerësimin e performancës të punës së ankuesit për vitin 2024, ngase sipas këtij formulari vet shqiptuesi i masës disiplinore ka paraqitur gjendje tjetër faktike nga arsyetimi i aktit në fjalë, duke vlerësuar ankuesin me aftësi të larta për përmbushje të detyrave të punës dhe për komunikim korrekt me drejtuesit, kolegët dhe palët, kështu që duke u bazuar në Nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtësues apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Andaj, bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se “*Vërejtja me shkrim*” me numër protokolli DKA Nr.120/25 të datës 17.01.2025, ku ankuesit sipas pikës I të dispozitivit i është shqiptuar masën disiplinore “*vërejtje verbale*”, është në nxjerrë përmes shkeljeve të ligjit material dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, dhe për pasojë ky akt administrativ është i paligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.438/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.K;
- Menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së